



NE NUK I NDAJMË TË DALAT BUXHETORE NË LINJË ETNIKE

Në fund të vitit fiskal, gjithmonë aktualizohet çështja e buxhetit, madje kjo çështje bëhet një patate e nxehtë politike, ku pozita dhe opozita ia hedhin në duar njëra-tjetrës. Në Maqedoni, në muajin dhjetor, figurë më e rendësishme se kryeministri u bë ministri i Financave Trajko Sllavevski, pasi në opinion lansoi një propozimbuxhet rekord, i cili u miratua më vonë nga Kuvendi. Për atë se çfarë ofron ky buxhet i ri, enkas për "Valutën" flet Ministri Financave, Trajko Sllavevski.

Evzal BEKTESHI

Valuta: z.Sllavevski, si e vlerësoni vitin financiar 2007 në RM, në aspekt të kompetencave që i keni si Ministri?

T. Sllavevski: Në aspekt të politikës fiskale dhe buxhetit, që janë domene të Ministrisë së Financave, kemi arsye të jemi të kënaqur. Para një viti në këtë kohë, në publik kishte dilema se a do të ketë sukses Qeveria, me vendosjen e tatimit të sheshtë dhe me këtë a do të mund të mbulojë të gjitha shpenzimet për vitin 2007, për financimin e shëndetësisë, arsimit, mbrojtjen kombëtare, sigurinë e brendshme, administratën publike dhe disa projekte kapitale. Ato dilema u treguan shumë pesimiste, pasi ne kemi rezultate shumë pozitive në këtë aspekt dhe të hyrat buxhetore, edhe pas uljes së tatimeve rrjedhimisht për 11 muajt e kaluar, janë për 21% më të larta në krahasim me periudhën e njëjtë të një viti më parë dhe deri më 10% më shumë se parashikimet tona. Gjatë vitit kemi bërë dy herë rebalansin e buxhetit, për rialokimin e mjeteve buxhetore, por përsëri nuk patëm sukses që t'i realizojmë. Për këtë shkak ishim të detyrur, para pak kohësh në parlament të propozojmë rialokim të mjeteve, me qëllim që të shfrytëzohen sipas parimeve të punës buxhetore, 45 milionë euro, me vendim të parlamentit për disa projekte të rëndësishme siç janë: Furnizimi me 45-50 autobus për

ndërmarrjen publike të transportit në Shkup, kredi për të papunësuarit, të cilët mund të fillojnë biznes privat me kamata nominale 1% dhe grejs periudhë prej një viti, me afat kthimi prej 3 vitesh, shuma e këtyre mjeteve mund të arrijë deri në 3 000 euro për projekt, në këtë mund të përfshihen maksimum 5 persona, ne besojmë që kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e numrit të papunësuarve, posaçërisht për ato grupe që janë në situatë të palakmueshme ekonomike, personat që kanë mbi 25 vjet përvojë pune dhe që nuk i plotësojnë kushtet për pension, pastaj me këto mjete parashihen edhe furnizimi me mjete për Ministrinë e Punëve të Brendshme etj. Ndihamë për përfundimin e ndërtimitin e objektit komunal në Dibër, Prilep dhe disa projekte të vogla, si lumi i Sllatinës etj. Të rezimojmë, do me thënë, të jemi të kënaqur me vitin 2007 në aspekt të politikës fiskale.

Valuta: A janë realizuar të gjitha parashikimet e buxhetit të vitit 2007?

T.Sllavevski: Do të ishte një situatë ideale nëse do të realizoheshin të gjitha parashikimet e bëra për shpenzimet dhe

projektet gjatë një viti. Është fakt se ne jemi të kritikuar nga opinioni se nuk kemi arritur të realizojmë disa projekte kapitale dhe investime kapitale. Ky mosrealizim u dedikohet shumë faktorëve, p.sh. në disa raste kemi hasur në pengesa juridike, mosgjedhja e kontesteve për pronën. Disa projekte kanë dështuar, për shkak të tenderëve të dështuar, të tjerë për përgatitje jo në kohë, por mund të them se realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2007, do të jetë në 70%, po do t'i shohim edhe rezultatet me projektet e fundit. Qeveria ka marrë masa, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, duke u bërë presion shfrytëzuesve buxhetor për të realizuar projektet kapitale. Për vitin që vjen nuk do të pritë shumë, por janë bërë të gjitha programet që shfrytëzuesit buxhetor do t'i zyrtarizojnë. Nuk do të tolerohet mosrealizimi i projekteve kapitale.

Valuta: Prej janarit të 2007-s është vendosur tatimi i sheshtë prej 12% për tatimin personal dhe tatimin e fitimit, çfarë rezultatesh ka dhënë ky zvogëlim?

T.Silaveski: Përmendëm edhe më lart se të hyrat buxhetore edhe pas uljes së tatimeve, rrjedhimisht për 11 muajt e kaluar, janë për 21% më të larta në krahasim me periudhën e njëjtë të një viti më parë dhe deri më 10% më shumë se parashikimet tona. Do të shtoj se ne e kemi mundësuar edhe uljen e shpenzimeve për bizneset, ky zvogëlim i shpenzimeve ka çuar në zvogëlimin e papunësisë. Po ashtu ky zvogëlim i tatimeve, i cili do të jetë 10% për tatimin personal dhe tatimin në fitim në janar të vitit 2008, ka çuar në uljen e ekonomisë së zezë, pasi bizneset më tepër do t'i regjistrojnë punonjësit e tyre dhe do të paguajnë tatimin në fitim.

Valuta: A do të ketë zvogëlim të TVSH-së në 2008 për produkte të caktuara?

T.Silaveski: Tash për tash nuk planifikojmë që të bëjmë ndonjë ulje të tatimit në vlerë të shtuar (TVSH), pasi mendojmë që uljet e TVSH-së prej 18% në 5% për disa produkte dhe shërbime janë të mjaftueshme. Këto ulje ishin të drejtuara, p.sh., për sferën e bujqësisë që të jetë më konkurruese për disa burime të energjisë, ose në mënyrë direkte për përmirësimin e jetës së qytetarëve, p.sh., me uljen e TVSH-së për barnat qytetarët do të blejnë barna më të lira.

Valuta: A mendoni se këto ulje të TVSH-së kanë dhënë rezultate në terren, pasi tash për shembull, transporti në relacion Shkup-Tetovë ishte 100 den, tash është 130 den. Pse?

T.Silaveski: Mendoj që ka. Sa i përket transportit, mendoj që në këtë rritje të çmimit kanë ndikuar faktorë të tjerë, siç

janë: rritja e çmimit të naftës, shpenzime të tjera, megjithatë mendoj që nëse nuk kishte ulje të TVSH-së për shërbimet e transportit të udhëtarëve, me siguri çmimet do të ishin më të larta. Veçanërisht në transportin publik punët nuk janë aq të thjeshta, pasi, p.sh., ndërmarrja publike për transport publik e Shkupit, vite me radhë nuk ka paguar TVSH dhe kalkulimi për ulje çmimesh është shumë i komplikuar.

Valuta: Sipas jush, cilat janë anët e mira të buxhetit për vitin 2008?

T.Silaveski: Në opinion u shtrua teza se ky është buxheti më i madh, për sa i përket shpenzimeve apo të dalave, të cilat zënë shifrën prej 2.2 miliardë eurosh dhe këtë e konsiderojnë si një gjë tepër tragjike, por unë them që punët nuk duhet shikuar në këtë mënyrë. Pasi buxheti nuk mund të jetë i njëjtë si para 10 vitesh. Të dalat (shpenzimet) buxhetore me normë relative janë 36-37% të GDP-së, ne dëshirojmë që edhe më shumë ta ulim këtë pjesëmarrje të të dalave buxhetore në GDP-në e përgjithshme dhe në vitin 2010 ta ulim në 35% besojmë se do ta arrijmë këtë. Edhe pse në norma absolute rritet te të dalat buxhetore, por po ashtu rritet edhe GDP-ja. Nuk kemi ndonjë pjesëmarrje relative prej 40-50% të dalava buxhetore në GDP-në e përgjithshme sikur në vendet skandinave. Nuk duhet të friksohemi nga kjo rritje e të dalave buxhetore, pasi ne kemi shumë nevoja në arsim, shëndetësi, mbrotje, infrastrukturë etj. Edhe po të kishim më tepër mjete do të ishte shumë mirë, por duhet që të shfrytëzohen në mënyrë të drejtë. Investimet kapitale për vitin 2008

do të jenë 16% nga shumata e përgjithshme e të dalave buxhetore dhe ata marrin pjesë me 5-5.6% në GDP-në e përgjithshme. Për herë të parë pas pavarësisht të Maqedonisë tejkalojmë shpenzimet për arsimin që më parë ishin 5% e GDP-së dhe themi që kjo sferë është shumë e rëndësishme, është një investim afatgjatë. Pasi në vitin 2008/2009 do të kemi shkollim të mesëm të obligueshëm etj.

Valuta: Sa është rritja e parashikuar e GDP-së për 2008?

T.Silaveski: Parashikojmë rritje të GDP-së diku rreth 6%-6.5%, e cila është një normë rritjeje solide dhe që mund të arrihet në Maqedoni. Këtu do të shtoja se këtë rritje do të arrijmë me mbajtjen në nivel të çmimeve gjatë vitit 2008, edhe përkundër presioneve të rritjes shokante të çmimeve, jemi dëshmitarë të rritjes së çmimeve të naftës, energjisë dhe produkteve ushqimore në të gjithë botën, norma e inflacionit parashikohet të jetë 2.5%, e cila është një normë e ulët e inflacionit dhe të themi se nuk ka kurrfarë ndikimi që do të shkaktojë ndonjë problem në ekonominë e vendit. Të theksoj se do ta realizojmë normën prej 6%, e parashikuar për rritjen e GDP-së për vitin 2007.

Valuta: Disa ekspertë të kësaj lëmie thonë se ky buxhet është si të tjerët. A është ky buxhet zhvillimor?

T.Silaveski: Buxheti ka komponenta zhvillimore, pasi dua të potencoj se në vitin 2005 vetëm 6 milionë euro kanë qenë të dedikuara për bujqësinë, kurse me buxhetin e vitit 2008 do të ketë 45 milionë





euro për këtë sektor të rëndësishëm. Ekspertët dhe mediat ndonjëherë përqendrohen vetëm në totalin e shpenzimeve e jo në brendësinë e tyre.

Valuta: Sipas buxhetit të projektuar për 2008, ende dominojnë shpenzimet rrjedhëse, edhe atë me 84%. Pse është ashtu? A Mendoni se shpenzoni shumë para për kampanja marketingu?

T.Sllaveski: Te shpenzimet rrjedhëse disa janë jodiskrete. Ky është një term profesional dhe është fakt se këtu nuk mundemi të kemi ndonjë fleksibilitet të theksuar. Nuk mund t'i zvogëlojmë shpenzimet për arsimin, për mbrojtjen kombëtare, ata janë fikse 2.3%, për policinë, finansimin e administratës publike, tashmë edhe me rritjen e parashikuar të pagave. Shumë mirë e keni theksuar, mendoj që mund të bëjmë në të ardhmen diçka të shpenzimet sociale. Këtu mund të bëhen kursime të konsiderueshme me një punë të mirë. Sipas vlerësimeve të opinionit, mendoj që nuk kemi shpenzuar shumë para për kampanja ministria jonë kishte vetëm dy kampanja të mëdha: ngritjen e vetëdijes për pagesën e tatimeve dhe pagesën me kartela pagesore. Mendoj se kishim efekt. Unë dua të besoj se te qytetarët arritëm ta rrisim vetëdijen për pagesën e tatimeve, sidomos të rrinjtë, kohëve të fundit, nuk e arsyetojnë mosepagesën e tatimeve, shpresojmë se në të ardhmen që edhe më shumë të ngrihet vetëdija.

Valuta: Vetëm 16% e të gjitha të dalave janë kapitale. Mendoni se vetëm më këto pak mjete do t'i realizoni të gjitha projektet e parashikuara?

T.Sllaveski: Për vitin 2008, qeveria do të jetë shumë më rigorozë për ata shfrytëzues buxhetor dhe ministritë, të cilët në kohë nuk do t'i realizojnë projektet kapitale. Po ashtu tek ata shfrytëzues buxhetor që është vlerësuar se nuk kanë mundur t'i realizojnë projektet kapitale, për vitin 2008 u janë zvogëluar mjetet.

Valuta: A ka para për gazifikim në Maqedoninë Perëndimore?

Z.Sllaveski: Pyetja është pak sugjestive. Gazifikimin në të ardhmen do ta sigurojë një kompani private, e dini që kishte probleme me Gamën. Po ashtu edhe hyrja në partneritet privat publik nuk mund të shfrytëzohet këtu. Me gazifikimin shumë pak kemi ecur përpara dhe vite të tëra ka pasur probleme. Personalisht nuk mund të parashikoj kur dhe në çfarë rrethanash do të bëhet ky rrjet gazifikimi në rajone të caktuara, por dua që kjo të ndodhë për të mirën e qytetarëve.

Valuta: Cilat projekte për shqiptarët janë parashikuar me shpenzimet kapitale?

T.Sllaveski: Më lejoni pak, që t'iu jap një vërejtje lidhur me këtë pyetje, pasi ne nuk i ndajmë të dalat buxhetore në linjë etnike. Qytetarët shqiptarë që jetojnë në Shkup, do t'i shfrytëzojnë autobusët e rinj që do të blihen me paratë nga Buxheti, pastaj për vitin 2008 kemi ndarë mjete për zgjerimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, ndërtimi i Fakultetit Ekonomik. Investime kapitale në sferën e kulturës, do të ndërtohet Biblioteka e Tetovës, qendra konservuese në Gostivar që është një investim prej 2 milionë eurosh, pastaj do të ketë edhe investime në rrugë regjionale. Me Bankën Botërore biseduam që të

investojmë në pikën kufitare në Jazhincë, pasi ajo është në gjendje katastrofale. Përsëri po e potencoj se ne nuk bëjmë dallime në baza etnike, por këto janë disa nga projektet ku popullata shqiptare është e përqendruar. Edhe pjesa lindore na bën vërejtje, se nuk investojmë në atë anë, por aq janë mundësitë dhe mundohemi ta nxjerrim maksimumin.

Valuta: Sa është numri i të punësuarve shqiptarë në Ministrinë e Financave?

T.Sllaveski: Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 544, kurse vetëm 71 janë shqiptarë, që do të thotë 13%. Por, numri i të punësuarve rritet vazhdimisht. Përkundër se kemi punësime nëpërmjet sekretariatit për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, personalisht i kam inkurajuar studentët e mi shqiptarë që të vijnë të punojnë në Ministrinë e Financave dhe jam i kënaqur me punën e tyre, u janë bashkuar ekipeve të punës dhe ndjekin seminare të ndryshme, kurse për gjuhë të huaja, sidomos angleze, pastaj kanë projekte edhe jashtë vendit.

Valuta: A do të ketë rritje të çmimeve gjatë vitit 2008?

T.Sllaveski: Norma e përgjithshme e infalcionit do të jetë 2.5%. Më shqetëson fakti i rritjes së çmimeve të ushqimit, por them që ai është një fenomen global. E dimë që rriten çmimet në bursat botërore. Rritja e çmimit të grurit në bursat botërore ka arritur rekorde dhe çmimi është rritur për 2 herë më shumë, sigurisht se kjo ndikon edhe te ne, pasi edhe ne importojmë nga jashtë grurë. Po ashtu, kemi edhe rritje të produkteve të qumështit, edhe pse kjo rritje te ne është më e ulët.

Valuta: Si e vlerësoni sektorin bankar në Maqedoni?

Z.Sllaveski: Sektori bankar ka rritje të konsiderueshme. Kemi hyrjen e bankave të huaja. Por, personalisht do të jem edhe më i kënaqur nëse investon edhe "Raifaissen Bank" në Maqedoni, pasi ajo është prezente në të gjithë rajonin. Në sektorin bankar rriten depozitat, po ashtu edhe kreditimi për qytetarët dhe bizneset dhe besoj se kjo rritje do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Likuidimi Bankës Maqedone, nuk ndikoi negativisht te qytetarët.

Valuta: Si e komentoni hyrjen e shumë bankave bullgare në këtë sektor?

T.Sllaveski: Nuk janë shumë, vetëm në Sileks Bankë do të hyjë banka bullgare, kurse për Bankën Postare ende Qeveria nuk ka vendosur, pasi ajo ka aksionin e artë te kjo bankë. Megjithatë, nuk janë shumë. ■